




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 07.11.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1176, të datës 18.10.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), nenin 34, paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të “Projekt-Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera” dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të “Projekt-Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera”.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e “Projekt-Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera”, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin - qytetarët e interesuar, në debatin publik të caktuar për datën: 18.11.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Arkivës.




**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.11.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1118, të datës 07.10.2016, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 11 të “Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera”, mori:

V E N D I M

Për formimin e “Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit dhe Sportistëve të vitit 2016”

1. Për formimin e “Komisionit vlerësues për zgjedhjen e “Krijuesit të vitit 2016”, në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:
 - 1.1 Islam Shabani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, anëtar;
 - 1.2 Halil Qerimi - Nënkyetar i Komunës për Komunitete, anëtar;
 - 1.3 Vjollca Konjusha - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Ridvan Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Ylber Islami - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.6 Hasan Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.7 Emin Emini - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Për formimin e “Komisionit vlerësues për zgjedhjen e “Sportistëve të vitit 2016” në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:
 - 2.1 Fatlum Berisha - Zyrtar i Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 2.2 Tomislav Danic - Zyrtar Administrativ për Komunitete, anëtar;
 - 2.3 Arjeta Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 2.4 Migjen Kolshi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 2.5 Elmi Shabani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 2.6 Fitore Simnica - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 2.7 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.

3. Detyrë dhe përgjegjësi e “Komisionit vlerësues”, nga pika një dhe dy e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për “Krijuesin dhe sportistët e vitit 2016”.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi**


 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
 Prilap/Blat: 141
 Data/Date: 07.11.2016
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.11.2016


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2016, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë

1. Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë për festën e 28 Nëntorit - Ditën e Flamurit.
2. Sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e vizitës zyrtare dhe kryerja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

[Signature]